



Drejtoria e Arsimit

Nr. 119-30423 2019

Klinë, 18.07.2019

Në bazë të nenit 11, paragrafi 1 i Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.72/2010), nenit 34, paragrafi 5 i Ligjit për Arsimin Parauniversitar nr.04/L-032, nenit 5, pika C e Ligjit për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës nr.03/L-068, nenit 2, pika 2 e UA nr.08/2014 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së drejtorit të institucionit edukativo-arsimor dhe aftësues, Drejtori i Drejtorisë për Arsim shpall:

### KONKURS PUBLIK PËR

### Drejtor të institucioneve edukativo-arsimore.

- SHFMU "Deshmoret e Qendrese" ne Gllarevë, numër reference: JPOOO39894

Koeficienti i pagws: 7.8

#### Detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të shkollës:

- Menaxhimi dhe administrimi i përgjithshëm i institucionit shkollor,
- Hartimin e planeve vjetore të punës dhe planin zhvillimor të shkollës,
- Koordinimi i punës me Këshillin e shkollës, aktivet profesionale dhe organet tjera qeverise në shkollë,
- Detyrat dhe obligimet që dalin në bazë të plan programit mësimor aktual,
- Ruajtja e dokumenteve dhe të dhënave ashtu si parashihet në Ligjin e arsimit dhe në aktet normative,
- Monitorimin e orëve mësimore,
- Vlerësimin e performancës së mësimdhënësve dhe stafit tjetër administrativ dhe teknik,
- Planifikimin e buxhetit të shkollës dhe menaxhimi sipas kërkesave;
- Ruajtjen e dokumentacionit financiar dhe llogaridhënia për shpenzimet buxhetore,
- Pjesëmarrjen në panelin për pranimin e kuadrit në shkollë,
- Nxjerrjen e vendimeve për themelimin e komisioneve të ndryshme në interes të shkollës,
- Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga ana e DKA-së dhe obligimet e përcaktuara me akte të tjera normative.

#### Për të gjitha pozitat:

Mbikëqyrësi:

Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Orari i punës:

40 orë

Kohëzgjatja e Emërimit:

Emërimi është me mandat 4 vjeçar.

#### Shkollimi i kërkuar për pozitat e kërkuara:

- Të kenë të kryer së paku arsimin universitar të nivelit themelor 4 vjeçar, 240 ECTS.
- Të kenë diplomë Universitare nga profilet arsimore të pranueshme për pozitën e mësimdhënësit sipas Udhëzimit për licencimin e mësimdhënësve dhe sipas normativit për Kuadrin mësimor dhe rregullativës tjetër ligjore.
- Të ketë licencë të rregullt për mësimdhënie ose të jenë në përfundim të procedurës së licencimit.

#### Përvoja, aftësitë dhe cilësitë e tjera:

- Së paku tri (3) vite përvojë pune në arsim.
- Të kenë të përfunduar me sukses një nga programet e akredituara të kualifikimeve profesionale për udhëheqje, administrim ose menaxhim të institucioneve edukativo – arsimore.
- Njohuri lidhur me ligjet, rregulloret e aplikueshme në fushën e arsimit dhe njohuritë lidhur me dokumentacionin shkollor dhe pedagogjik të nxënësve.
- Shkathësi në komunikim, planifikim dhe koordinim të punës së personelit në nivel të shkollës.

- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve e këshillave profesionale.
- Shkathtësi në komunikimin elektronik, kompjuterik në aplikacione të programeve (Word, Excel, Pwer Point, Access etj).

#### **Dokumentet e nevojshme:**

- Dokumentet personale (certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit);
- Diploma e kualifikimit e noterizuar;
- Certifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT,
- Dëshmia e licencës së mësimdhënësit (vendimi dhe licenca ), ose dëshmia që është në proceduarë të licencimit,
- Dëshmia e përvojës së punës në arsim,
- Portfolio profesionale ( sipas udhëzimeve në shtojcën G të UA nr 08\2014)
- Letër-referencë nga një institucion publik kredibil si MASHT-i, DKA-ja, Këshilli drejtues i shkollës, punëdhënësi paraprak ose nga institucionet e arsimit të lartë. Letrat e referencës duhet të kenë përmbajtje dëshmuese për punën dhe angazhimin paraprak.
- Plani zhvillimor i institucionit edukativ arsimor dhe aftësues për të cilin konkurron ( së paku 10 faqe tekst me hapësirë 1.5 dhe me font të shkronjave Arial, madhësia 11, sipas udhëzimeve të MASHT-it,
- Certifikata shëndetësore e lëshuar nga një institucion publik shëndetësor me të cilën dëshmohet gjendja shëndetësore e kandidatit.
- Dëshmia se kandidati nuk është nën hetime.

#### **Mënyra e Aplikimit:**

Formularët për aplikim merren në **Drejtorinë e Arsimit** dhe dorëzohen po në të njëjtën drejtori.

Për informata me të hollësishme mund të kontaktoni në **Drejtorinë e Arsimit** direkt ose përmes **telefonit fiks 03820043727**.

**Konkursi mbetet e hapur 15 ditë** nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik. Dokumentet e pakompletuara dhe pas afatit nuk pranohen.

Ligji i Shërbimit Civil ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore si dhe nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

